



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. \_\_\_\_ Prot

Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2022

**NJOFTIM**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 3 (tre) vende vakante për pozicionin e punës: **Punëtor Skene pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik.**

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

**Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:**

1. Të këtë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional;
2. Të njohë mirë teknikat e montimit, lëvizjet mekanike të gropës së skenës, zhvendosjen e kulisave, shtangetave dhe çdo gjë që lidhet me mbarvajtjen e punës në skenë;
3. Të këtë njohuri në profesione si njohës i mirë i drurit (marangoz) apo mekanike si dhe profesione të tjera që ndihmojnë në kompetimin e tij si teknik në skenë;
4. Të kryejë punën që i ngarkohet, duke zbatuar me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë;
5. Të respektojë orarin e punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave;
6. Të zbatojë rregulloren e brendshme të institucionit, si edhe të mos silltet në kundërshtim me rregullat e etikës;

7. Të respektojë urdhërat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit me përjashtim të rasteve kur ndryshojnë kushtet e kontratës së punës si dhe kur këto urdhëra rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij.
8. Të mos përdorë pronën shtetërore për përfitime private.

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

1. Jetëshkrimi CV;
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara.
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

**Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP( zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së [sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al) deri me datë 03/10/2022.** Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor [www.tkob.gov.al](http://www.tkob.gov.al); faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

**DREJTORE e PËRGJITHSHME**

**Abigeila VOSHTINA**